



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.12/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit B.A, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga M. V., me banim në rrugën “Xh. Sh.”, nr., në P., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 21.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga M. V., ndaj gjyqtarit B.A, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 24.10.2022, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke vepruar konform nenit 9 par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë ankesën disiplinore të parashtruar nga M. V., me banim në rrugën “Xh. Sh.”, nr., në P., ndaj gjyqtarit B.A, me arsyetimin se gjyqtari ka bërë shkelje esenciale pasi nuk ka pranuar të dalë në vendin e ngjarjes, nuk ka pranuar që djali i paditësit dhe dëshmitarin H. Q., që të dëshmojnë, nuk i ka marrë për bazë deklaratat e dhjetë dëshmitarëve të dhëna në seancat gjyqësore të viteve 2018/2019, nuk i ka marrë për bazë letrat e paditësit që dëshmojnë se është përmbushë obligimi i pagesave (ratave) për blerjen e tokës e as kronologjinë e shitjes/ndërrimit të tokës në vitet 1970/1986. Përfundimisht, ka theksuar se seancat gjyqësore nuk kanë qenë në nivel, kanë qenë të njëanshme dhe nuk është sqaruar çështja. Si provë në ankesën disiplinore ka bashkëngjitur foto të ndryshme familjare, vërtetime, procesverbale të seancave gjyqësore, Aktgjykime dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit.

Me datë 24.10.2022, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga M. V., nga P. ndaj gjyqtarit B.A.

Gjyqtari B.A, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës, ka deklaruar se lëndën juridiko civile të paditurve Xh. M. dhe M. M., tani V., me numër:, fillimisht është gjykuar nga gjyqtari Nexhat Musaj, tani i pensionuar, e cila lëndë sipas vendimit të Gjykatës së Apelit është kthyer në rigjykim. Në rigjykim, kjo lëndë i është ndarë me sistem dhe gjatë shqyrtimit dhe vendosjes në këtë çështje ka theksuar se ka qenë i drejtë, i pavarur dhe i paanshëm, duke vendosur sipas bindjes së tij të lirë, të mbështetur në provat materiale dhe të bazuar në ligj, si dhe që në fillim të procedurës i ka pyetur palët se a kanë vërejtje që i njëjti të jetë gjyqtar i çështjes dhe palët janë përgjigjur se nuk kanë vërejtje. Lidhur me pretendimet se nga gjykata nuk janë ftuar disa palë, i njëjti ka theksuar se si gjyqtar e ka parë të arsyeshme dhe është bindë se me provat që gjenden në shkresat e lëndës të marrë një vendim të tillë, të bazuar në prova dhe në fakte pa qenë i ndikuar nga pretendimet e palëve të cilat nuk kanë mbështetje në provat materiale por, qëllimi i të cilave është vetëm prolongimi i procedurës dhe vendosjes. Sa i përket pretendimit të

parashtruesve të ankesës se, gjyqtari ka nxjerrë aktgjykim të kundërligjshëm, gjyqtari ka theksuar se palët në procedurë kanë të drejtën e ankesës duke theksuar se, vendimin e tij e vlerëson të drejtë dhe të bazuar në prova ndërsa, ankesën disiplinore tërësisht të pabazuar në prova dhe fakte.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit B.A, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është e pabazuar.

Parashtruesi i ankesës, ka parashtruar ankesë disiplinore mbi pretendimet se gjyqtari ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore duke mos pranuar të dalë në terren, duke mos i marrë për bazë deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në procedurën e mëparshme, duke mos i marrë për bazë disa prova dhe se çështja nuk është sqaruar në tërësi. Lidhur me këto pretendime, autoriteti kompetent gjen se, arsyet e tilla mbi të cilat është mbështetë ankesa disiplinore janë pretendime ankimore, të cilat janë objekt vlerësimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të njëjtat nuk mund të trajtohen si shkelje të natyrës disiplinore pasi, fakti se cilat prova gjyqtari i vlerëson si të rëndësishme për t'i administruar, mënyra e vlerësimit të provave të administruara dhe mënyra e vendosjes nga ana e gjyqtarit në një çështje, është kompetencë dhe autorizim ekskluziv i gjyqtarit, i garantuar me ligj, saktësia dhe ligjshmëria e të cilave sfidohet nga Gjykata e Apelit, sipas ankesës së parashtruar nga pala e pakënaqur.

Ndërsa, sa i përket pretendimit të parashtruesit të ankesës se gjyqtari B.A është treguar i njëanshëm, autoriteti kompetent ka gjetur se këtu parashtruesi i ankesës M. V., pretendimin e tillë nuk e ka mbështetë në asnjë provë me të cilën do të argumentohet si i saktë dhe i bazuar pretendimi i ankuesit.

Andaj, nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - AD/GJTHPE/.nr.12/22, me datë 21.11.2022

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit B.A*
- 3. Parashtruesit të ankesës – M. V.i*